



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 6333 Prot.

Lezhë, më 26 / 05 /2020

VENDIM

Nr. 64 Datë 22 . 05 .2020

“PËR

**MIRATIMIN E SHEMBJES SË NDËRTESES “PALLATI NR. 3, LAGJJA GURRA,
ME KOORDINATA 41.775584N, 19.653519E”, QYTETI LEZHE, SI REZULTAT I
DËMTIMIT NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, nenit 42, pika 1, shkronjat “b” dhe “d”, nenit 57, nenit 58 të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar dhe Aktit Normativ Nr. 09, date 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Lezhë,

V E N D O S I:

- 1- Miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesës së dëmtuar “Pallati nr.3” (i identifikuar sipas sistemit të adresave “Godinë Ekzistuese Nr. 23), në rrugën “Kol Toma 03070049”, me Nr. 2/78+1-12, 2/78+1-1, 2/78+1-6, 2/78+1-7, 2/78+1-9, 2/78+1-3, 2/78+2-18, 2/78+1-4, 2/78+2-26, 2/78+3-8, 2/78+2-23, 2/78+1-27, 2/78+2-13, 2/78+2-21, 2/78+2-29, 2/78+2-28, 2/78+1-25, 2/78+1-14, 2/78+2-19, 2/78+2-30, 2/78+1-11/1, 2/78+1-20, 2/78+2-1, 2/78+1-11/2, 2/78+1-11/1, 2/78+2-27/3, 2/78+2-24, 2/78+1-15, 2/78+1-18, 2/78+1-10, Pasurie, e ndodhur në Qytetin e Lezhës, në pronësi të pronarëve të njëjësive të banimit të kësaj ndërtese të dëmtuar, sipas aktespertizës së thelluar e cila i është nënshtruar oponencës teknike dhe miratuar për prishje të detyruar nga Instituti i Ndërtimit, pasi struktura e objektit nuk plotëson kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë dhe objekti përbën rrezik për jetën e banorëve, bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2- Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
- 3- Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Mjedisit, mbështesin Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit.
- 4- Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, njofton 24 orë përpara ndërhyrjes për shembjen e objektit, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë. Ndërhyrja për shembjen e objektit bëhet në prani të përfaqësuesit të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe Policisë së Shtetit.

- 5- Për ushtrimin e përgjegjësiave dhe detyrave të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të kërkojë asistencën dhe bashkëpunimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.
- 6- Një kopje e këtij vendimi i njoftohet menjëherë pronarëve të njësive të banimit në këtë ndërtesë, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Drejtorisë Vendore të Policisë Lezhë dhe Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.
- 7- Ngarkohen Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Policia Bashkiake, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturës dhe Mjedisit, Drejtoria e Kujdesit Social Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria Emergjencave Civile për zbatimin e këtij vendimi.
- 8- Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI
Florida ÇUNAJ

KRYETARI
Ernest RAKAJ

